



Albanian-American
Development Foundation



KONKURSI I PRANIMIT

NË

**FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE
URBANISTIKËS**

Vitin akademik 2026 – 2027

VARIANTI 0

Kodi i sekretimit:

1) Akropoli ishte pjesë e organizimit në qytetet e:


- A) Greqisë së lashtë
- C) Egjiptit të lashtë

- B) Perandorisë Osmane
- D) Romës së lashtë


2) Në një magazinë, kemi 60 kuti me produkte të barabarta në formë kubike të vendosura në mënyrë që të formojnë një kuboid me dimensione $5 \times 4 \times 3$. Mbas disa kohësh shihet që kutitë të cilat kishin kontakt me të paktën një faqe nga ajri ose me dyshtemenë ishin prishur. Sa janë kutitë të cilat nuk janë dëmtuar?

- A) 30
- B) 6
- C) 12
- D) 24

3) Në figurë paraqiten projeksionet e disa trupave gjeometrikë. Cila nga alternativat e dhëna paraqet pamjen aksonometrike të saktë të tyre ?



- 4) Në planimetrinë e paraqitur në cilën dhomë (secila e treguar me një numër) ndodhet hyrja për në apartament?



A) 2

B) 4

C) 5








D) 3

- 5) Cili nga çiftet vepër - autor është i saktë?

A) “Lulet e Verës” - Gjergj Fishta
C) “Vargjet e Lira” - Migjeni

B) “Mërgata e Qyqeve” - Fan Noli
D) “Andrra e Jetës” - Ernest Koliqi

- 6) Në figurë paraqiten aksonometritë e shkallëve. Cila nga alternativat e dhëna korrespondon me planet e sakta të tyre?



A) 2C; 1A; 4D, 3B.

B) 1C; 2A; 3D, 4B.

C) 1D; 2A; 3B, 4D.

D) 1A; 2C; 3D, 4B

7) Në sekuencën e mëposhtme numri X është:

6	(4)	14
10	(10)	30
12	(11)	34
20	(25)	70
25	(X)	53

A) X= 14


B) X= 16

C) X= 18

D) X= 44


8) Lidhni tipin e perspektivës me paraqitjen grafike të dhënë:

1. Perspektivë në lartësinë e njeriut.
2. Perspektivë nga poshtë.
3. Perspektivë nga lart.



A) 1-c; 2-b; 3-a

B) 1-b; 2-a; 3-c



C) 1-a; 2-b; 3-c

D) 1-b; 2-c; 3-a

9) FMN do të thotë:


- A) Federata Monetare Ndërkombëtare
C) Forumi Monetar Ndërkombëtar

- B) Fondi Monetar Ndërkombëtar
D) Fondi Multilateral Ndërkombëtar

10) Gjeni pohimin e saktë. Kongresi i Manastirit u mbledh në vitin:


- A) 1912 dhe trajtoi çështjen ekonomike.
B) 1908 dhe trajtoi çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe.
C) 1920 dhe trajtoi çështjen e lirisë themelore.
D) 1878 dhe trajtoi çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe.

- 11) Është dhënë aksonometria e vijës së thyer ABC. Cili nga projeksionet në planet e projekimit tregon madhësinë reale të segmentit të tij?



- A) Projeksioni b'c'. B) Projeksioni a'b'. C) Projeksioni ab. D) Projeksioni bc.

- 12) Në figurë paraqitet trupi gjeometrik në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?



- A) 2 B) 3 C) 4 D) 1


- 13) Cila rrugë e lashtë lidhte Romën me Kostandinopojën?

- A) Rruga e Mëndafshit B) Rruga Mbretërore Persiane
C) Via Egnatia D) Via Appia



- 14) Kush është autori i romanit "Don Kishoti"?

- A) Victor Hugo B) William Shakespeare
C) Dante Alighieri D) Miguel de Cervantes


- 15) Ndërmjet 4 figurave të mëposhtme, tregoni se cilat mund të rotullohen e kombinohen në mënyrë që të formojnë figurën në krah.




- A) Figura 3 dhe 4
B) Nuk është e mundur
C) Figura 2 dhe 3
D) Figura 1 dhe 2
- 16) Parlamenti i Shqipërisë ka:
A) 150 deputetë
B) 180 deputetë
C) 120 deputetë
D) 140 deputetë
- 17) Andi, Bianka, Ceni dhe Danieli kanë sëbashku 166 kuba. Danieli ka katërfishin e Cenit dhe Andi ka 6 kuba më shumë se sa Ceni. Ceni ka sa gjysma e Biankës. Sa kuba ka Andi?
A) 44
B) 26
C) 40
D) 20
- 18) Në figurë paraqitet shpërthimi aksonometrik (exploded axonometric) i një trupi solid gjeometrik. Cili nga trupat e dhënë i korrespondon?




1



2



3



4

A) 4

B) 3

C) 1

D) 2

19) Cili është oqeani më i madh?



A) Atlantik

B) Paqësor

C) Arktik

D) Indian

20) Drini gjeti një ushtrim enigmatik me skemë trekëndore ku secili numër në rrjeshtin e poshtëm formohej nga shuma e dy numrave që kishte më sipër, saktësisht si në figurën më poshtë majtas. Skema e ushtrimit të Drinit ishte prishur dhe kishin ngelur vetëm 4 numra të lexueshëm si në figurën më poshtë djathtas. Gjeni cili numër qëndron në vendin e pikëpyetjes “?”.










A) 15

B) 25

C) 20

D) 35

21) Lidhni boshtet me paraqitjen aksonometrike përkatëse të cilindrit.




A) 3C, 2A, 1D, 4B

B) 3D, 4B, 1A, 2C

C) 2A, 4B, 1C, 3D

D) 1B, 2D, 3C, 4A

22) Në figurë paraqitet plani i prerë me tre rrafshë. Cila nga alternativat e dhëna korrespondon me prerjet e sakta të tij?



A) 1A-A; 2C-C; 3B-B.
C) 2B-B; 1C-C; 3A-A.

B) 3B-B; 1C-C; 2A-A.
D) 1A-A; 2B-B; 3C-C.

23) Një drejtkëndësh e ka perimetrin 160cm dhe gjysma e gjatësisë së tij është 10cm më e madhe se gjerësia. Sa është syprina (sipërfaqja) e drejtkëndëshit?

A) 6000 mm² B) 1200 cm² C) 1800 mm² D) 1600 cm²


24) Si ishte i organizuar qyteti osman?

A) Rreth amfiteatrit dhe pazarit.
B) Rreth pazarit, objekteve fetare dhe publike.
C) Rreth forumit dhe objekteve fetare dhe publike.
D) Rreth kalas, objekteve publike.


25) Cili traktat krijoi zyrtarisht Bashkimin Evropian?

A) Traktati i Mastrihtit B) Akti Final i Helsinkit
C) Traktati i Versajës D) Traktati i Varshavës

- 26) Në figurë paraqitet çatia e parë nga lart, ku linja ABCD është në një plan horizontal dhe pjerrësia është konstante. Cila është pika më e lartë e çatisë?




- A) Pika F. B) Pika D. C) Pika E. D) Pika A.
- 27) Në një enë ndodhen 20 litra ujë me 15% kripë. Për të ulur përqendrimin e kripës, shtojmë 10 litra ujë të pastër. Sa do të jetë përqendrimi i kripës në përzierjen e re?
- A) 10% B) 7% C) 12% D) 5%
- 28) Cili regjim u shpall në Shqipëri më 1 shtator 1928?
- A) Monarki B) Protektorat italian
C) Republikë D) Shtet federativ
- 29) Sa faqe ka trupi gjeometrik i paraqitur me dy projeksione?



- A) 7 faqe B) 4 faqe C) 5 faqe D) 6 faqe
- 30) Gjeni alternativën e gabuar.
- A) Mendimtarët iluministë mbronin pushtetin absolut dhe privilegjet feudale.
B) Mendimtarët iluministë mbronin ligjin dhe lirinë.
C) Mendimtarët iluministë vlerësonin përdorimin e arsyes.
D) Mendimtarët iluministë kritikojnë autoritetin tradicional.

31) Cilat prej paraqitjeve me projeksione, korrespondojnë me trupin e dhënë në aksonometri ?




A) 2-5

B) 4-2

C) 4-6

D) 1-3


32) Gjeni figurën që mungon.



A)



B)



C)




D)




- 33) Lexoni të dhënat e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjes. Aldo, Bledi, Ceni, Dori, Elio, Flora dhe Greta janë shtatë fëmijë. Mosha e secilit është një numër i plotë dhe moshat e tyre janë shtatë numra të njëpasnjëshëm, të vendosur diku midis 1 dhe 10 vjeç. Jepen këto informacione: Dori është 3 vjet më i vogël se Aldo. Bledi ka moshën e mesme të grupit. Aldo është 2 vjet më i madh se Bledi. Flora është më e vogël se Bledi me po aq vite sa Ceni është më i madh se Dori. Greta është më e madhe se Flora.
- Sa vjet më i vogël është Elio se Greta?
- A) 4 B) 5 C) 2 D) 6
- 34) Në një vend ku taksat mbi të ardhurat janë 20%, një person paguan 3000 euro taksa. Sa janë të ardhurat e tij?
- A) 29,000 euro B) 12,000 euro C) 15,000 euro D) 6,000 euro
- 35) Një tipar dallues i ekonomisë në Shqipëri gjatë regjimit komunist ishte:
- A) Planifikimi i centralizuar dhe privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore.
B) Planifikimi i centralizuar dhe ekonomi e kontrolluar.
C) Konkurrenca e lirë dhe liberalizimi i tregut.
D) Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe shtetëzimi i pronës private.
- 36) Në një parukeri $\frac{4}{5}$ e klienteve janë me flokë të errët (të zeza ose kafe), dhe $\frac{3}{4}$ kanë sytë me ngjyrë të errët. Mund të biem dakort që:
- A) Të paktën $\frac{11}{20}$ e klienteve të parukerisë kanë edhe flokët edhe sytë me ngjyrë të errët.
B) $\frac{3}{4}$ e klienteve të parukerisë kanë edhe flokët edhe sytë me ngjyrë të errët.
C) Mbi $\frac{11}{20}$ e klienteve të parukerisë kanë edhe flokët edhe sytë me ngjyrë të errët.
D) $\frac{3}{5}$ e klienteve të parukerisë kanë edhe flokët edhe sytë me ngjyrë të errët.
- 37) Regjimet totalitare i përdorën sheshet kryesisht për:
- A) Organizimin e tregjeve të lira nga qytetarët.
B) Ekspozimin e artit avangard.
C) Zhvillimin e ceremonive fetare.
D) Organizimin e paradave dhe propagandë.

38) Në figurë paraqitet plani i nje relievi i parë nga lart. Cila nga alternativat e dhëna paraqet prerjen tërthore A-A të saktë të tij?



A) 1

B) 3



C) 2

D) 4

39) Cili nga qytetet ka qenë qendra e Principatës së Arbrit?

A) Kruja

B) Shkodra

C) Durrësi

D) Janina

40) Një person peshohet në një peshore të vendosur mbi një plan të pjerrët. Pesha e treguar në peshore do të jetë:

A) më e madhe se pesha reale

B) nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t'u përgjigjur

C) më e vogël se pesha reale

D) pesha reale

41) Për të kryer pastrimin e shtëpisë, Aldo, Beni dhe Dori harxhojnë të tre sëbashku 2 orë. Nëse ata do i ndihmojë edhe Era sa kohë do t'u duhet fëmijve pët të pastruar?


A) 2 orë

B) 30 minuta


C) 1 orë

D) 1 orë e 30 minuta


42) Zgjidhni figurën/diagramin që paraqet saktë marrëdhënien ndërmjet bashkësive të termave të dhënë: lule; trëndafila; tulipanë.




A)



B)



C)



D)

43) Cili është gazi më i bollshëm në atmosferën e Tokës?

- A) Oksigjeni
C) Argoni

- B) Azoti
D) Dioksidi i karbonit

44) Goni është më i gjatë se sa Tili; Tili është më i shkurtër se sa Pali; Pali është më i gjatë nga të tre shokët. Në bazë të këtyre të dhënave, cili nga pohimet e mëposhtme, është i vërtetë?

- A) Tili nuk është më i shkurtër i shokëve.
C) Goni është më i shkurtër nga të tre.

- B) Pali është më i gjatë se sa Goni.
D) Tili është më i gjatë nga të tre shokët.

45) Njeriu ka:

- A) 46 kromozome
B) 48 kromozome
C) 44 kromozome
D) 23 kromozome

46) Sa numra të ndryshëm 4 shifrorë mund të formohen duke përdorur numrat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 pa i përsëritur ata, në mënyrë të tillë që numrat katër-shifrorë të jenë të pjestueshëm me 5?


- A) 60
B) 120
C) 24
D) 48

47) Cili nga shoqërimet e mëposhtme mes veprës dhe autorit nuk është i saktë?

- A) “Darka e fundit” - Leonardo Da Vinci
C) “Puthja” - Gustav Klimt

- B) “Motra Tone” - Vangjush Mio
D) “Nata me yje” - Vincent van Gogh

48) Janë dhënë formatet A0, A1, A2, A3, A4, A5. Zgjidhni raportin korrekt të përmasave ndërmjet tyre.



A) 1

B) 3

C) 2

D) 4

49) Gjeni numrin që mungon.

2	4	12
3	5	?
1	1	4

A) 16

B) 17

C) 5


D) 22

50) Cilat tipare riktheu arkitektura e Rilindjes?

- A) Asimetrinë e qëllimshme, shkallën monumentale dhe mohimin e antikitetit.
B) Standardizimin industrial dhe blloqet e banimit masiv.
C) Fortifikimin, errësirën e brendshme dhe format vetëm ushtarake.
D) Thjeshtësinë, elegancën dhe format klasike.

- 51) Dy makina nisen nga dy qytete të ndryshme, A dhe B, të cilat ndodhen 330 km larg njëra-tjetrës. Makina e parë niset nga qyteti A drejt qytetit B me shpejtësi 70 km/orë. Një orë më vonë, nga qyteti B niset makina e dytë drejt qytetit A me shpejtësi 60 km/orë. Pas sa kohe nga nisja e makinës së parë do të takohen?
- A) 1 orë B) 2 orë e 30 min C) 3 orë D) 2 orë
- 52) Tri orë tringëlljnë: e para çdo 3 orë, e dyta çdo 4 orë, e treta çdo 5 orë. Sot, e martë, ato tringëllinë njëkohësisht në orën 16:00. Në cilën ditë dhe në cilën orë do të tringëlljnë sërish njëkohësisht herën pasardhëse?
- A) E mërkurë ora 16:00 B) E premte ora 4:00
C) E premte ora 4:00 D) E enjte ora 4:00
- 53) Tregoni cili numër ndjek sekuencën: 7, 20, 46, 98, 202, 410, ...
- A) 826 B) 820 C) 814 D) 612
- 54) Cilat masa nxitën reformat e Shqipërisë drejt ekonomisë së tregut në fillim të viteve 1990?
- A) Privatizimi i pronës dhe liberalizimi i çmimeve.
B) Kolektivizimi i tokës bujqësore.
C) Ndalimi i pronës private.
D) Rikthimi i planifikimit të centralizuar.
- 55) Cili objekt është përfaqësues i amfiteatrit në arkitekturën romake?
- A) Kisha e Shirgjit B) Bazilika e Linit
C) Manastiri i Pojanit D) Koloseu
- 56) Cili ishte synimi kryesor i Konferencës së Pezës?
- A) Bashkimi i shqiptarëve në një front të përbashkët antifashist
B) Njohja e administratës italiane
C) Ndërprerja e qëndresës së armatosur
D) Rikthimi i menjëhershëm i monarkisë

57) Rrethi i dhënë përfaqëson projeksionin në planin horizontal të trupave:



1.sferë, cilindër.

2.sferë, cilindër, kon me kulm poshtë.

3.kon, cilindër.

4.kon, piramidë.

A) 3

B) 4

C) 1

D) 2

58) Cila prej kishave përshkruhet si monumenti më i madh i arkitekturës së hershme bizantine?

A) Kisha e Shën Sofisë

B) Kisha e Shasit

C) Kisha e Shën Vitalit

D) Bazilika e Shën Pjetrit

59) Cili nga piktorët e mëposhtëm nuk i përket rrymës së impresionizmit?


A) Édouard Manet

B) Pablo Picasso

C) Claude Monet

D) Pierre-Auguste Renoir

60) Dua të ndërtoj një 'piramidë' me 4 nivele me gurë në formë kubash, si në figurën më poshtë: në nivelin më të lartë ka vetëm 1 kub, një nivel më poshtë ka 3, e në këtë mënyrë vazhdon. Sa kuba duhet të vendos gjithsej?



A) 18

B) 20

C) 22

D) 16

Answer Key

Testname: TEZA 2026

- 1) A
- 2) B
- 3) A
- 4) A
- 5) C
- 6) B
- 7) A
- 8) B
- 9) B
- 10) B
- 11) B
- 12) D
- 13) C
- 14) D
- 15) D
- 16) D
- 17) B
- 18) C
- 19) B
- 20) B
- 21) C
- 22) A
- 23) B
- 24) B
- 25) A
- 26) C
- 27) A
- 28) A
- 29) C
- 30) A
- 31) D
- 32) C
- 33) D
- 34) C
- 35) B
- 36) A
- 37) D
- 38) A
- 39) A
- 40) C
- 41) D
- 42) D
- 43) B
- 44) B
- 45) A
- 46) A
- 47) B
- 48) A
- 49) A
- 50) D
- 51) C
- 52) B, C
- 53) A
- 54) A

Answer Key

Testname: TEZA 2026

55) D

56) A

57) D

58) A

59) B

60) B